



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 25/18
Prishtinë, më 24.05.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić ,
Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, dhe Enver Hoti.

Munguan: Fikrim Damka, Dardan Molliqaj dhe Blerim Kuçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Safet Hoxha – Kryetar nga Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (tutje: KRPP), Ismet Abdullahu –ZKF nga KRPP, Emine Fazliu –nga Zyra Kombëtare e Auditimit (tutje : ZKA), Ramadan Gashi –Drejtor nga ZKA, Agim Sheqiri - ZKF nga Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik (tutje:OSHP), Blerim Dina –Kryetar nga OSHP, Valon Kurtaj – Drejtor nga Akademia e Drejtësisë (tutje: AD), Faton Fetishi- nga AD.

Pjesëmarrës tjerë : Amire Qamili-Gazetare nga BIRN, Albulena Avdiu-Gazetare nga Ekonomia Sot, Donika Osmani – Gazetare nga Ekonomia Online , Rabije Hyseni-Praktikante nga Zyra për marrëdhënie me publikun dhe Fitore Sopjani – Praktikante nga Zyra për M.P.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit ,dt.08.05. 2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2018;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor financiarë të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetsim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete , Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-027 për Miniera dhe minerale dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik , Infrastrukturë,Tregti , Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 08.05. 2018

Kryetari - konstatoi se procesverbali i datës 08.05.2018, miratohet pa asnjë vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2018

Kryetari: Fjalën ia kaloi kryetarit të Bordit të na bëjë një prezantim të Raportit Vjetor të KRPP-së për vitin 2018.

Safet Hoxha: Raporti është i dizajnuar në katër pjesë, ka pjesën hyrëse e cila ka të bëjë me misionin e KRPP-së dhe ndarjen e saj, është raporti i përgjithshëm që përmban grumbullimin e raportimit të autoriteteve kontraktuese, është raporti që i dedikohet punës së institucionit dhe raporti financiar bashkë me rekomandimet. Pasqyra e KRPP-së ka një përmbajtje si vijon, numri i kontratave të nënshkruara për vitin 2017 është 10.214 kontrata publike të nënshkruara, në krahasim me vitin 2016 kemi një rritje të kontratave rreth 200 kontratave, vlera e kontraktive në vitin 2017 është 354 milionë kontraktive qeveritare, ndërsa 109 milionë janë nga kompanitë publike, 2 milionë janë nga OJQ dhe organizata tjera pra gjithsej i kemi 459.789.000 euro. I kemi ndarë në raport pagesat që janë bërë për autostradën Hani i Elezit-Prishtinë sepse nuk është kontratë e vitit të kaluar por është pagesë që është bërë për një kontraktim më herët. Ne kemi bërë një analizë katër vjeçare ku kemi një rritje për 4 milionë pra 77% e kontratave janë qeveritare, 22 % janë të kompanive publike në nivel të Kosovës gjithsej 163 euro, përpjekje kontraktuese që kanë operuar gjatë vitit 2017 dhe prej tyre nuk janë funksionale disa OJQ të cilat janë të regjistruara.

Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara në bruto produktin vendor është 7.35% pa llogaritur vlerën e autostradës , ndërsa me autostradë është 10.24% e GDP është e shpenzuar përmes procedurave prokurimit publik. Nga buxheti i Kosovës i kemi 351 milionë , kemi nga të hyrat 97 milionë që në krahasim me vitin 2016 kemi një rritje prej 17 milionë të prokurimit të hyrave vetenake kemi kursin e njëjtë nga ai qeveritar dhe donacionet janë të njëjta pra, rritja e të hyrave vetenake është dikun rreth 37 milionë në total.

Poashtu kemi të ndarë vlerën e kontratave të nënshkruara mbi bazën e strukturës së financimit, një çështje tjetër kemi të bëjmë me kontratat e nënshkruara sipas llojit se a është punë apo furnizim e në krahasim me vitin e kaluar kemi ulje të furnizimeve nga 119 në 159 milionë, shërbimet i kemi në shkallën e njëjtë, kemi ngritje në nivelin e punëve diku për 67 milionë ka rritje të prokurimeve për punë për të cilën mendoj se është një inkubator i mirë i vendit. Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2017 sipas llojit të prokurimit, me 66% e prokurimeve në autostradë janë punë, 24% janë furnizime dhe 8% janë shërbime në autostradë ndërsa pa autostradë kjo vlerë ndryshon me 52 % punë , 34% furnizime dhe 8 % shërbime.Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit, 400 milionë janë proceduar me procedurë të hapur, 3 Milionë me procedurë të kufizuar do të thotë të gjithë inkubatorët janë pozitiv në aspektin e përqindjes 87%, procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është 9.12 % e cila cilësohet si e lartë.

Totali i aneks kontratave për vitin 2017 është 3.948.000 euro pra një nivel i ultë i përdorimit të punëve shtesë. Sipas afatit kohor prokurimi devijon duke i ngushtuar afatet kemi një indikator mjaft të mirë sepse 95% e procedurave të prokurimit në Kosovë janë zhvilluar në afatet normale kohore ndërsa 4.9% ka pas shkurtime të afateve. Kemi një rënie të ofertuesve në krahasim me vitin 2016. Sa i përket aktiviteteve dhe punës në vitin që lam pas kemi nxerrë edhe dy rregulloren njëra për procedurat e dhënies së çertifikatës, poashtu kemi nxerrë një akt me 6 interpretime të cilin e kemi publikuar në web faqe me qëllim të sqarimit të nenin 9.4. Raporti financiar për vitin 2017 i kemi pas gjithsej 307,799 euro për paga dhe mëditje, 117.000 euro mallra dhe shërbime, shpenzime komunale 5,000. Shkalla e realizimit të këtij buxheti në total është 81.56% kemi ngecje të realizimit të buxhetit dy pozicione në paga dhe mëditje sepse nuk kemi arrit me i rekrutuar ku kemi shpallë konkurs diku 4 herë për shkak të pagës së ulët neve na kanë ardhë IT fillestar ku nuk kanë prodhuar gatishmëri edhe pse 4 herë kemi shpallë konkursin megjithatë dua të ndërlihem me faktin se paga sikur të kishte mundësi të rritet për këtë pozitë si dhe ka qenë një pjesë që pagesa është vonuar për shkak se kontraktimi për KRPP, AQF-ja, konkretisht ka pas vonesa dhe kjo e ka ulë këtë shkallë.

Kryetari: Fjalën dua t'ia kaloj menjëherë zyrës kombëtare të auditimit më konkretisht Znj.Emine dhe Z.Ramadan Gashi që të na bëjë prezentimin e raportit për KRPP-në.

Emine Fazliu: Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar raportin e pasqyrave financiare për vitin 2017, opinionin që e kemi dhënë ne për këto pasqyra është opinion i pamodifikuar që do të thotë se pasqyrat paraqesin një pamje krejtësisht të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. KRPP-ja realizimin e buxhetit e ka jo shumë të kënaqshëm pra 82%, e nëse nisemi prej kateogorive ekonomike kemi një deficit të mjeteve te kategoria e pagave dhe mëditjeve prej 60.000 euro e cila ka ndikuar që i gjithë realizimi i buxhetit të jetë më i ulët , gjithashtu edhe te mallrat dhe shërbimet kemi si rezultat i mosrealizimit të kontratës për mirëmbajtjen e prodhimit elektronik ky mos realizim ka ndikuar që ekzekutimi i buxhetit të jetë 77%, ndërsa tek investimet kapitale kemi një buxhet i cili është realizu në tërësi. Sa i përket pjesës tjetër të raportit ne kemi dhënë 4 rekomandime që ndërlihen me pagat dhe mëditjet, menaxhimin e pasurisë, zbatimin e rekomandimeve dhe raportimi menaxherial i menaxhimit të rrezikut, poashtu vlen të potencohet se kryetari i KRPP-së është pajtuar me përmbajtjen e këtij raporti ndërsa është zotu se ka me i miratu. Vlen të potencohet që plani i riveprimit është rishikuar.

Kryetari: Ndoshta kish qenë mirë me implementu edhe një plan të ri me rekomandime edhe të viteve paraprake pra 2015,2016 dhe të këtij viti 2017 sepse nuk janë vërejtje të mëdha por janë disa çështje që duhen me u adresu. Dua të parashtrij disa pyetje, po e nis me shkresën që na ka ardhë prej Ministrisë së Integritimit Europian ë fletë për mospërputhshmërin e nenit 9.4, respektivisht të interpretimit të këtij neni me MSA-në dhe aq sa munda me e kuptu ju e keni dhënë mendimin tek Ministria e nuk jeni pajtuar siç duket me ta, andaj dua ti di opinionet e juaja për këtë çështje?

Sa i përket raportit kam disa pyetje: e para ka të bëjë me E-Prokurimin, dua të kem vlerësimin tuaj se a është më transparent dhe kur do të kalojmë plotësisht në prokurim elektronik? E dyta më intereson si i përzgjedhni këto 38 institucione që i monitoroni, a i zgjedhni në bazë të buxhetit apo shkeljeve që i bëjnë? E treta më intereson bashkëpunimi që e keni me OSHP-në me Autoritetin e Konkurrencës dhe përfundimisht Prokurinë e Kosovës, a keni ndonjë trup bashkëpunues që i trajtoni çështjet të shkeljeve të procedurave të ligjeve dhe e fundit prej meje ku e kam marrë një kërkesë prej Organizatave të Shoqërisë Civile që në publikimin e kontratave të futet edhe numri fiskal, jo vetëm emri i biznesit. Po ashtu më intereson mendimin tënd profesional çfarë mase e ul korrupsionin, prokurimi elektronik?

Enver Hoti: Dua të potencoj rreth gjendjes aktuale sa i përket çmimeve sepse kjo gjendje po determinon edhe në mungesën e realizimit të këtyre projekteve për shkak se po e merr një çmim lirë dhe nuk përcjellat dinamika e punës dhe ne kemi ngecje në këtë çështje, ku jemi futur në një situatë ku kemi

dëme, andaj pyetja ime ka të bëjë me faktin se a keni gjetur diku ndonjë penalizim për mosrealizim të projekteve?

Safet Hoxha: Sa i përket e-prokurimit ne duhet të dijmë që projekti i fundit ka nisë prej vitit të kaluar ku ka vazhduar në këtë Qeveri fuqishëm për me u instalu është një platformë shumë e madhe e them publikisht se Kosova në fushën e prokurimit është në mesataren e BE-së duke qenë para Sllovenisë, Bullgarisë e shumë vendeve tjera sepse para dy jave kemi qenë në Rumani në një konferencë dhe kemi marrë matjet ku ekziston edhe raporti i Sigmës për këtë që e them. Platforma e prokurimit e Kosovës është një nga platformat më të gjera të prokurimit elektronik në Kosovë që fillon nga iniciimi i procedurës, prokurimi, vlerësimi, e-ankesa, e-ankandi, e-menaxhimi i kontratës dhe pagesës që në total përfshijnë gjithë ciklin e prokurimit publik. Për momentin kemi në aplikacion tre module pra kemi e-regjistrimin, e-prokurimin dhe vlerësimin elektronik i cili mund të bëhet në distancë.

Ne kemi bërë një matje të vitit të kaluar kemi pas një shkallë të ulët të prokurimit ku ne e kemi lënë si mundësi alternative derisa ne si shtet të ofrojmë trajnim. Pritjet tona e para besoj që do të ulim koston e ofertimit si për elektronik dhe për kontraktues, e dyta do ta rrisë besueshmërinë, e treta do të jetë në kohë reale i zhvilluar i gjithë procesi i prokurimit publik. Momentalisht 97% e të gjitha procedurave zhvillohen përmes e-prokurimit, janë të regjistruara 186 autoritete kontraktuese, 6.000 operatorë ekonomik, numri i përdoruesve ditorë 14.000, 17.000 publikime janë bërë deri tani, aktualisht 50% e aktiviteteve kanë së paku 1 ofertë elektronike në Kosovë ndërsa 30% e totalit të ofertave janë oferta elektronike.

Sa i përket çështjes së nenit 9.4 dhe dilemave që janë ngrit për përdorim dua të sqaroj se neni 9.4 nënkupton që një autoritet publik para se me i inicuar procedurat të prokurimit publik duhet me u siguru që nuk janë ato të mira në dispozicion të autoriteteve tjera, ne kemi marrë një opinion prej një eksperti për këtë nen dhe opinionin e tij e kemi publikuar i cili cek se meqenëse Kosova nuk është pjesëtare e BE-së nuk ka asnjë arsye me trajtu MSA-në.

Safete Hadërgjonaj: unë nuk kam diçka serioze me ngrit. Mua më vjen mirë që meqenëse ruajmë kontinuitetin e raportimit nga KRPP-ja që nga viti në vit, ka përmirësime të dukshme sa i përket fushës së prokurimit. Ne jemi të interesuar që sa më shpejtë të shkojmë në përdorimin e prokurimit elektronik sepse çështja e prokurimit ka qenë shumë e diskutueshme dhe na ka ulë në një farë mënyre edhe imazhin ndaj faktorit ndërkombëtarë. E mbajë mend nga raportimet e kaluara, që kontratat e negociuara kanë qenë me një përqindje të lartë dhe tash po e shohim se janë vetëm dy kompani Posta dhe KEK-u, të cilat njëra i kish 5 milionë e tjetra 10 milionë që kishin bërë prokurim të panegociuar. Por edhe vitin e kaluar kështu ka qenë me këto dy kompani dhe është mirë që të analizohet një çështje e tillë dhe të shihet se çka mund të bëhet në këtë drejtim sepse procedurat e hapura janë më transparente.

Ajo që dua ta them ne në Komisionin për Buxhet në të kaluarën kemi pas një praktikë që rekomandimet që kanë dal nga Raporti i progresit sidomos këtë periudhën e fundit i kemi bërë pjesë të punës sonë e ndoshta do të ishte më mirë, meqenëse kemi Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim jo vetëm këto, por ta shikojmë edhe planin e reformave ekonomike të cilat janë shumë të rëndësishme për BE-në dhe ti bëjmë edhe pjesë të planit të punës sonë ta diskutojmë dhe ta gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2018

Kryetari: ju lus për një prezentim të raportit vjetor të OSHP-së.

Blerim Dina: OSHP për vitin 2017 ka pranuar dhe ka zgjidhur gjithsej 553 ankesa, i ka aprovuar vendimet në 161 raste, ndërsa në 281 raste i ka kthyer lëndët ku paneli shqyrtues ka gjetur se nga ana autoriteteve kontraktuese ka pasur shkelje. Në 41 raste ka bërë anulimin e atyre procedurave dhe i ka kthyer në ritenderim, në 26 raste ka bërë flakje të ankesave, 16 raste kemi tërheqje, 18 raste urdhëresa ku nuk janë zbatuar vendimet që i ka lëshuar OSHP-së.

Emine Fazliu: Sa i përket planifikimit dhe realizimit të buxhetit ne kemi këtë gjendje, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është më i ulët për 20.000 euro dhe kjo ka ndodhur si rezultat i reduktimit të Grantit Qeveritar për projektin Sistemi për Menaxhimin e Ankesave dhe ky reduktim është bërë me vendim të Qeverisë. Në vitin 2017 OSHP-ja ka shpenzuar 292.014 euro pra 89% të buxhetit final e në këtë nivel të ekzekutimit të buxhetit ka ndikuar niveli i ulët i realizimit tek pagat dhe mëditjet ku kemi një tepriçë prej 18.000 euro, kjo ka ndodhur si rezultat i suspendimit të dy zyrtarëve gjatë vitit si dhe masat disiplinore të marra edhe ndaj zyrtarëve të tjerë. Realizimi i ulët ishte edhe tek mallra dhe shërbimet, përkundër këtyre kemi mjete të pashpenzuara të kësaj kategorie rreth 18.000 euro. Pjesa tjetër e raportit ne kemi dhënë 5 rekomandime që ndërliken me paga dhe mëditje, mallrave konkretisht ka të bëjë me pagesat e mobileve dhe një biletë e pashfrytëzuar e aeroplanit në menaxhimin e pasurisë, zbatimin e rekomandimeve si dhe me menaxhimin e rrezikut për këto rekomandime që i kemi dhënë kryetari i OSHP-së është pajtuar dhe është zotuar se do të realizojë.

Kryetari: shikova se i keni trajtuar mbi 500 raste e vetëm një gjobë e keni dhënë kjo është e njëjta me vitet paraprake, përveç vitit 2015 ku i keni dhënë 25 gjoba, andaj më intereson me ditë çka ndodh nëse nuk përfillet, a keni ndonjë kontakt në prokurori? E dyta ka të bëjë me faktin se që nga 2009 janë disa dënime të cilat nuk po mundeni me i inkasuar do të thotë a është gjyqësore apo ku qëndron problemi? Sa jeni të punësuar 22 apo 23?

Enver Hoti: nga raporti që e dëgjua pra janë 500 raste dhe nga ai rezultat 200 raste i kanë shkuar për shkelje të ligjit dhe mua më intereson të di se çka ndodh me ata zyrtarë të cilët ende e detyrën e vet ku e shkel ligjin?

Safete Hadërgjonaj: ne e kemi analizuar raportin dhe e shohim që numri i ankesave po rritet vit pas viti shtrihet dilema a po rritet numri i ankesave sepse njerëzit po bëjnë më shumë gabime apo janë vetëdijësuar operatorët ekonomik që duhet me bë ankesa? Do të ishte mirë që ndoshta ju si institucion të bëni një hulumtim për çfarë arsye po rritet gjithë ky numër. Nëse kanë shkuar në rivlerësim 281 lëndë është shumë, dhe kur kanë shkuar në rivlerësim çka ndodh me to, mandej a kanë dalë të drejta veprimet të organeve kontraktuese apo operatorëve ekonomik? Pra ju jeni një far gjykate e tenderave prandaj keni një përgjegjësi të madhe. Pashë raportin e shpenzimeve ku shpenzimet deri më 31.12 janë 192.228.9 euro zotimet deri më 31.12 janë 192.228, kur të shpenzohen këto hiqen prej zotimit kjo kolonë pra është e shënuar keq.

Blerim Dina: OSHP kur e shqyrton ankesën së pari lëshon vendim lidhur me të pra nëse vendimi nuk zbatohet nga ana kontraktuese operatori ekonomik ankohet tek ne. Ne lëshojmë urdhëresë me u zbatu vendimi e nëse nuk zbatohet urdhëresa atëherë ne e dënojmë autoritetin kontraktues. Të hyrat nga gjobat derdhen në buxhetin e Kosovës, shumica e tyre nuk paguhen ne jemi duke u munduar përmes përmbaruesve të përfundohet. Sa i përket zyrtarëve të cilët e shkelin ligjin, ne e kthejmë në rivlerësim e nëse ai e përsërit shkeljen ne kërkojmë nga KRPP me ja anuluar licencën. Numri i ankesave, në mungesë

të stafit nuk kemi bërë ndonjë hulumtim, por nëse shikojmë raportin vjetor deri sa ka shkuar duke u rritur ku deri në vitin 2016, ka ndryshuar ligji.

Safete Hadërgjonaj: Kur shkon lënda në rivlerësim dhe komisioni rivlerësues i autoritetit kontraktues prap i jep të drejtë të njëjtit operator, a ka të drejtë ankohet përsëri operatori?

Blerim Dina: Po, ka të drejtë të ankohet operatorit i njëjtë.

Kryetari: Po e shoh që ka njëfarë mospërputhje mes OSHP-së dhe KRPP-së pastaj lihen kështu edhe rastet kur zyrtarët bëjnë shkelje, unë besoj që duhet me qenë një trup bashkëpunues.

Agim Sheqiri : janë disa raporte financiare ku miraton vetë Kuvendi që është shumë e vështirë me punu me to , andaj do të doja të bëja kërkesë për ndryshimin e këtij formulari për raportim financiar që të jetë në eksel.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018.

5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor financiarë të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017

Safete Hadërgjonaj: Këtu kemi raportin financiar të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017, ja jap fjalën ta prezantoni në pika të shkurtëra raportin financiar.

Valon Kurtaj: ,sa i përket aspektit financiar me ligjin mbi buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti fillestar i AD-së ka qenë 663.884 euro. AD-ja ka pranuar donacione në vlerë prej 16.127 euro, ku 14.400 euro janë donacion nga Këshilli i Europës në implementimin e projektit të KE-së nëpërmjet projektit Rufrex që ka të bëjë me nenin 10 të konventës europiane për të drejtat e njeriut. Njëkohësisht kemi pranuar një donacion prej 1.127 euro nga donatori GIZ në implementimin e programit trajnues hyrës për gjyqëtarët dhe prokurorët të cilët janë integruar në marrëveshjen e drejtësisë të arritur në Bruksel.Sa i përket buxheti përfundimtar sipas kategorive, ka qenë si në vijim në paga dhe mëditje ka qenë 204.383 euro, mallra dhe shërbime 390.668 euro prej të cilave 374.541 euro janë nga Buxheti i Kosovës, shpenzime komunale kemi 12.500 euro.

Emine Fazliu : ZKA ka publikuar raportin e auditimit për pasqyra financiare për AD-në dhe kemi dhënë një opinion të pamodifikuar , theksimi i çështjes e kemi pasi që vlera e pasurive nën 1000 euro nuk paraqet një gjendje të saktë kjo ka ndodhur si rezultat i një donacioni nga BE-ja për vitin 2015 e cila nuk është regjistruar ndërsa ecurinë e buxhetit pak a shumë e prezantuan. Në këtë raport kemi dhënë 5 rekomandime njëri që lidhet me theksimin e çështjes , tek kategoria e pagave dhe shtesave që ka të bëjë me pagesën e pushimit të lehonisë, mbulimin e pozitave në ushtrues detyre , menaxhimin e pasurisë dhe raportimin menaxherial dhe rrezikut .Një prej sfidave që edhe ne e kemi cek në këtë raport është numri i vogël i stafit që paraqet vështirësitë në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive, vlen të potencohet edhe AD-ja i ka pranuar përmbajtjen e raportit si dhe është pajtuar që të pranojë rekomandimet.

Kryetari: këto institucione që po pajtohen me rekomandimet e juaja si zyrë kombëtare, a po i vënë në funksion pranimet e tyre?

Emine Fazliu: po pajtohen sepse me monstat që i kemi jemi me raste konkrete dhe kemi dëshmi për atë që e paraqesim.

Valon Kurtaj : merren masa nga vetë institucioni që këto të gjetura me u eliminu vitin tjetër , kemi pas edhe të gjetura që janë të vitit 2016 në fakt mirëpo ato janë eliminu e në mënyrë sistematike rekomandimet e auditorit i marrim shumë me seriozitet dhe i aplikojmë. Shembull e kemi regjistrimin e asetëve të pranuar si donacion këtu e japim ne një arsyetim dhe auditori e ka dhënë po atë arsyetim në raportin e auditimit nëse lexohet në mënyrë më analitike. Këtu kemi të bëjmë që donatori që na ka dhënë neve mjetet ose asetet ka qenë politikë e donatorit mos me mbulu çmimin e vlerës së asetit ne kur kemi bërë procedurën e prokurimit dhe nuk e kemi dit vlerën, kemi rikërku të bëhet regjistrimi dhe ne kemi shkruar disa herë komunikimin me donatorët për me mujt me i regjistru në regjistër dhe si aset nuk kemi mundur. Tash si solucion nuk kam zgjidhje tjetër vetëm se konsultim edhe me auditorin do ta formojë një komision të posaçëm i cili do ti jep një vlerë asetëve dhe këto asetë të regjistrohen me një vlerë e cila do të jetë e përafërt në treg. Sa i përket rreziqeve ne kemi pas listën e rreziqeve mirëpo në raportimin e rreziqeve ne kemi bërë një raport të cilin brenda menaxhmentit e raportojmë por këtë vit meqenëse ka qenë edhe kërkesë e auditorit që të jetë një raport më specifik që edhe auditori të ketë qasje.

Kryetari: Sa ndërtesa i keni me qira edhe sa paguani qira?

Valon Kurtaj: Kemi një ndërtesë 75.000 euro, ku kemi 25 punëtorë kemi sallat e trajnimit.

Safete Hadërgjonaj: Edhe këta kanë të njëjtin raportim sikur institucioni i mëparshëm , shpenzimet dhe zotimet i kanë bërë të njëjtat vlera , kur mjetet zotohen për me u shpenzu e kur shpenzohen hiqet zotimi dhe nuk është mirë me figuru kjo kolonë këtu tabela 4.b.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, miratimin e Raportit Vjetor financiar të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetsim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete , Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Kryetari: në bazë të opinionit të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetsim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete , Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-027 për Miniera dhe minerale dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti , Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari: në bazë të opinionit të Ministrisë së Financave, Projektligji përmban implikime buxhetore shtesë. Kostoja shtesë ka të bëjë me punësimet e reja. Me nenin 58.3 është përcaktuar se pagat dhe shtesat e personelit të KPMM-së, i cakton Bordi, duke marrë parasysh nivelin e pagave të sektorit që rregullon. Sa i përket amendamenteve të komisionit funksional, amendamenti 28 me të cilin është riformuluar neni 45.1 është përcaktuar që Rentat minerare të mbledhura nga KPMM-ja, janë të hyra të përgjithshme të Republikës së Kosovës, 20% e kësaj rente rialokohet nga buxheti qendror për buxhetin e Komunës ku zhvillohet aktiviteti minierar, i dedikuar në mënyrë specifike në zhvillim të komunitetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit.

Propozojë që të ndryshojmë Paragrafin 3 të nenit 58 ndryshohet si në vijim:

3. Pagat dhe shtesat e personelit të KPMM-së, përcaktohen në pajtueshmëri me legjislacionin e shërbimit civil.

Gjithashtu me qëllim të specifikimit se të hyrat që realizon KPMM mbi planifikimet buxhetore të derdhen në Buxhetin e Kosovës, në nenin 59, pas paragrafit 1 të shtohet një paragraf i ri 2, me tekstin si në vijim:

2. Të hyrat e mbledhura nga KPMM-ja, në formën e taksave, licencave dhe tarifave tjera, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, të cilat i tejkalojnë planifikimet buxhetore të KPMM-së, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, të rekomandojmë që të fshihet amendamenti 28 i Komisionit funksional dhe të mbetet teksti si në projektligj dhe amendamenti 29 i propozuar nga Grupi Parlamentar Lista Serbe.

Pas diskutimit dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji Nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale, përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentet në Projektligjin Nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 58, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3. Pagat dhe shtesat e personelit të KPMM-së, caktohen në pajtueshmëri me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Pagat e nëpunësve civilë.

Amendamenti 2

Neni 59, pas paragrafit 1 të shtohet një paragraf i ri 2, me tekstin si në vijim:

2. Të hyrat e mbledhura nga KPMM-ja, në formën e taksave, licencave dhe tarifave tjera, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, të cilat i tejkalojnë planifikimet buxhetore të KPMM-së, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, me qëllim të harmonizimit me amendamentin 1 të propozuar

me këtë raport, i rekomandon Komisionit FunkSIONAL, që të ndryshojë nenet e Projektligjit, që statusi dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës të të punësuarve të KPMM-së, të bëhet në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

4. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin Nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale dhe amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 28 dhe amendamentit 29.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që të fshihet amendamenti 28, dhe të mbetet teksti siç është në Projektligj, si dhe të fshihet amendamenti 29 i propozuar nga Grupi Parlamentar Lista Serbe

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku